




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

THIRRJE PUBLIKE

FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE TË GRAVE 2025

UDHËZUESI PËR APLIKANTËT

Autoriteti kontraktues:

Komuna e Gjilanit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve:

Nga 28.03.2025 deri me 28.04.2025 ora 16:00

Përmbajtja

1. THIRRJA PUBLIKE „FONDI PËR PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE TË GRAVE 2025.....	3
1.1. Synimi Kryesor	4
1.2. Synimet Specifike	4
1.3. Përkrahja financiare publike e ofruar nga autoriteti kontraktues	4
1.4. Vlera monetare e granteve	4
1.5. Bashkëfinancimi në projekt	5
2. RREGULLAT PËR APLIKIM	5
2.1. Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 1-bizneset Start-up.....	5
2.2. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim per LOT 1.....	5
2.3. Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 2 Bizneset ekzistuese te grave.....	6
2.4. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim per LOT 2 Bizneset ekzistuese te grave.....	6
2.5. Kostot e Kualifikueshme	7
2.6. Kostot e pa kualifikueshme	7
2.7. Veprimtaritë që nuk kualifikohen	8
3. FAZAT E VLERËSIMIT	8
3.1. Kontrolli administrative.....	8
3.2. Vleresimi i projekt propozimit-kriteret.....	9
3.3. Kontrolla ne teren.....	9
4. PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR PËR APLIKIM	10
4.1 Periudha e aplikimit.....	10
4.2 Menyra e aplikimit dhe afati i fundit për aplikim	10
4.3 Numri i aplikimeve	10
4.4 Informata të mëtutjeshme për aplikim.....	11
4.5 Kohezgjatja dhe Plani i veprimit.....	11
4.6 Nënshkrimi i Kontratës dhe ankesat.....	11
4.7 Orari indikativ.....	12

1. THIRRJA PUBLIKE „FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE TË GRAVE 2025

Komuna e Gjilanit bazuar në mandatin ligjor edhe këtë vit lanson thirrjen publike “Fondi për subvencionimin e bizneseve start-up dhe bizneset ekzistuese të grave 2025” që për synim ka promovimin dhe mbështetjen e sektorit privat për zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve prodhuese, perpunuese dhe shërbyese, rritjen e konkureshmërisë së produkteve dhe shërbimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, krijimin e mundësive bizneseve për qasje në financa, zëvendësimin e importeve ekzistuese dhe nxitja e eksportit si dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik lokal.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik lokal, është e domosdoshme që të mundësohen pajisje dhe teknologji të reja në mënyrë që të rritet produktiviteti, stabiliteti, dhe qëndrueshmëria e bizneseve në sistemin e prodhimit, përpunimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Komuna e Gjilanit dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka për objektiv të mbështesë këta sektorë: **PRODHIMIN, PËRPUNIMIN DHE SHËRBIMET.**

1.1 Nga sektori i prodhimit dhe përpunimit do të përkrahen këto veprimtari:

- 1.1.1. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga plastika**
- 1.1.2. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga druri,**
- 1.1.3. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga llamarina,**
- 1.1.4. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga lëkura,**
- 1.1.5. Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit,**
- 1.1.6. Artizanatet.**

1.2. Nga sektori i veprimtarisë së shërbimeve do të përkrahen këto veprimtari

- 1.2.1. Ofrimi i shërbimeve të marketingut digjital,**
- 1.2.2. Ofrimi i shërbimeve filmike dhe të produksionit,**
- 1.2.3. Ofrimi i shërbimeve të riparimit të pajisjeve elektro shtëpiake,**
- 1.2.4. Ofrimi i shërbimeve të arkitekturës, gjeodezisë dhe kontabilitet**
- 1.2.5 Ofrimi i shërbime shëndetsore (ordinancat fizioterapeutike, dentare dhe shërbimeve laboratorike)**
- 1.2.6. Ofrimi i shërbimeve estetike**
- 1.2.7. Ofrimi i shërbimeve për servisim/riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve**
- 1.2.8. Ofrimi i shërbimet të programimit (IT)**

Komuna e Gjilanit përmes këtij fondi mbetet e përkushtuar të mbështesë projektet e qëndrueshme dhe të fuqizoj ato në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitet e tyre profesionale, menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate të biznesit.

Komuna e Gjilanit do të organizoj sesion informues për aplikantët potencial / bizneset sa i përket mënyrës së aplikimit.

1.1. Synimi Kryesor

Kjo thirrje publike ka për synim kryesor zhvillimin e ekonomisë lokale përmes mbështetjes për bizneset ekzistuese të grave dhe krijimin e bizneseve të reja duke ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve dhe avancime të reja teknologjike në pajisje dhe makineri të nevojshme në procesin e punës. Po ashtu përmes kësaj mbështetje publike synihet edhe krijimi i vendeve të reja të punës dhe zvogëlimi i papunësisë.

1.2. Synimet Specifike

- Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë;
- Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial në rritje duke i dhënë prioritet bizneseve në fushën e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK);
- Stimulimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes prodhimit, përpunimit dhe shërbimeve.

1.3. Përkrahja financiare publike e ofruar nga autoriteti kontraktues

Buxheti i kësaj thirrje është 150,000.00€ (njqind e pesëdhjetë mijë euro) që do të ndahet për bizneset start-up dhe bizneset ekzistuese të grave (Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla). Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion, apo të ndryshojë shumën në varësi buxhetore.

Komuna e Gjilanit, buxhetin në dispozicion për vitin 2025, do ta ndajë në dy kategori:

- **LOT 1- Bizneset Start Up;**
- **LOT 2- Biznese ekzistuese të grave (Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla-NMV);**

Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:

1. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtorë;
2. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtorë.

1.4. Vlera monetare e granteve

Çdo aplikacion i dorëzuar në këtë thirrje për mbështetje publike duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:

LOT 1- Start-up

Nga 500.00€ deri në 3,000.00€;

LOT 2- Bizneset ekzistuese të grave (Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla-NMV)

Nga 1,000.00€ deri në 4,000.00€;

1.5. Bashkëfinancimi në projekt

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët është obligative.

Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë Start-up si dhe Biznese ekzistuese te grave duhet te jete nga 10% deri 40% nga vlera pergjithshme e projektit.

Kontributi në natyrë nuk konsiderohet bashkëfinancim.

2. RREGULLAT PËR APLIKIM

Ky udhëzues përcakton rregullat, kushtet dhe kriteret e pranueshme si dhe ato të papranueshme në procesin e thirrjes për mbështetje publike që nga faza e aplikimit, përzgjedhjes dhe implementimit. Në këtë thirrje janë tri kriteret të kualifikueshme:

- Aplikantët që mund të kërkojnë mbështetje publike;
- Veprimtaritë për të cilat mund të jepet mbështetja publike;
- Lloji i kostove që mund të merret në përcaktimin e shumës së mbështetjes publike.

2.1.Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 1-Bizneset Start-up

1. Regjistrimi i biznesit duhet te bëhet para nënshkrimit te kontrates. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Gjilanit.
2. Të jetë biznes që operon në Komunën e Gjilanit, ku edhe do të bëhet investimi;
3. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
4. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 35 vjeçare, si dhe komunitetet jo shumicë;
5. Pronari/ja i/e biznesit duhet të jetë banor i Komunës së Gjilanit.

2.2. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 1- Start-up përfshijnë:

1. Formulari i Aplikimit për LOT 1- Bizneset Start UP; (Shtojca A1)
2. Buxheti dhe burimet e financimit; (Shtojca B)
3. Kopja e dokumenti identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
4. Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt *(oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës. Oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje publikee).*¹ Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO

¹ Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet pa miratimin e DZHE.

Vërejtje: Dokumentet per aplikim, mund të shkarkohen nga web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit. Dokumentet e bashkangjitura duhet të jenë me dukshmëri të qartë.

2.3 Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 2 - bizneset ekzistuese të grave

1. Të jetë ndërmarrje në pronësi të grave dhe 100% private (sipas definicionit të Kosovës) regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.
2. Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e pranimin të grantit;
3. Të jetë biznes që operon në Komunën e Gjilanit, ku edhe do të bëhet investimi;
4. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
5. Pronarja e biznesit duhet të jetë banorë e Komunës së Gjilanit.

2.4. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 2- Bizneset ekzistuese të grave përfshijnë:

1. Formulari i Aplikacionit për bizneset ekzistuese të grave NMV; (Shtojca A2)
2. Buxheti dhe burimet e financimit; (Shtojca B)
3. Kopja e dokumenti identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
4. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët (informatat përcjellëse) sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese të grave)
5. Vërtetimi tatimor (jo më i vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje publike me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe apo obligime aktuale tatimore të pashlyera) apo marreveshja me ATK për ri-programim të borxheve ose obligime.
6. Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës. Oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje publikee*). ¹ Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO
7. Foto të pajisjeve dhe objektit ku biznesi ushtron veprimtarinë (fotot duhet të jenë të dukshme qartë).

Vërejtje: Dokumentet per aplikim, mund të shkarkohen nga web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit. Dokumentet e bashkangjitura duhet të jenë me dukshmëri të qartë.

¹ Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet pa miratimin e DZHE.

2.5. Kostot e Kualifikueshme

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e thirrjes llogariten si shpenzime të kualifikueshme, dhe mund të financohen sipas kësaj Thirrje Publike:

Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, përmirësimin e proceseve të prodhimit/ofrimit të shërbimeve duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm.

2.6. Kostot e pa kualifikueshme

Kostot vijuese nuk kualifikohen:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbje dhe detyrime potenciale të ardhshme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kreditë ndaj palëve të treta;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzimet e amortizimit, që normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës në të cilën ndahen fitimet;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe medijt;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari (Tavolinat, karriget dhe dollapet, në përjashtim ato që ndërlidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë)

Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet.

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. falsifikimi i faturave, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mos-pagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime

shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Është në interesin e aplikantit të paraqes buxhet realist dhe efektiv për kostot.

Komisioni vlerësues në rast se dyshon për çmime të manipuluar dhe jo reale, ka të drejtë të marrë sqarime nga Dogana e Kosovës, ATK dhe inspektoriati i tregut. Në rast se Komisioni konfirmon se çmimet e ofruara në ofertë/a dhe buxhet nuk janë realiste, mundet që aplikacionin ta diskualifikojë për mungesë korrektësie.

2.7. Veprimtaritë që nuk kualifikohen

Sektorë që **NUK KUALIFIKOHEN** për këtë thirrje janë:

- **TREGTIA** (me pakicë e shumicë),
- **NDËRTIMTARIA**,
- **ARSIMI**
- **SHËNDETËSIA** (përveq veprimtarive të listuara në pikën 1.2.5) dhe
- **BUJQËSIA** (përveq veprimtarive të listuara në pikën 1.1.5 si dhe *çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushëveprimtarinë e bujqësisë e që financohet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ministria Bujqësisë*)

3. FAZAT E VLERËSIMIT

3.1. Kontrolli Administrativ

Në fazën e kontrollit administrativ të aplikacioneve për grante, Komuna e Gjilanit do të shqyrtojë dhe verifikojë aplikacionet e pranuar. Në këtë fazë verifikohet se a janë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të kërkuara në udhëzues.

Në përgjithësi, faza e kontrollit administrativ të programit të grantit është një hap i rëndësishëm për të siguruar që fondet e grantit të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe efektive, dhe që projektet e zgjedhura janë në përputhje me udhëzimet në këtë dokument.

Aplikimet që nuk kalojnë kontrollin administrative, nuk kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit.

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një kontroll administrativ për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit (p.sh. aplikantët janë shtetas të Kosovës, si dhe biznesi është regjistruar në Kosovë dhe vepron në territorin e Komunës së Gjilanit).

3.2. Vlerësimi i projekt-propozimit – kriteret

Projektet që kalojnë fazën e kontrollit administrativ, kalojnë në fazën e vlerësimit të projektit. Kjo fazë do të përfshijë vlerësimin e zbatueshmërisë dhe impaktit të mundshëm të projekteve të propozuara, si dhe rëndësinë e tyre për ekonominë dhe komunitetin lokal.

Procesi i vlerësimit teknik do të konsiderojë nëse aplikacioni demonstroi që ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të kësaj thirrje publike për të ndihmuar zhvillimin ekonomik lokal.

Vlerësimi bëhet me poentim nga Komisioni Komunal, duke u bazuar në tabelën e më poshtme, e cila rrjedh nga qëllimet e kësaj thirrje.

	Pikët
Ideja e biznesit dhe inovacioni	Totali(30 pikë)
Idetë inovative	15 pikë
Potenciali për adresimin e një nevoje ose një problemi real	10 pikë
Potenciali për eksport	5 pikë
Potenciali i tregut dhe përvoja e aplikuesit	Totali(25 pikë)
Madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes	10 pikë
Avantazhi konkurrues dhe diferencimi	10 pikë
Përvoja dhe aftësitë përkatëse të aplikuesit	5 pikë
Qëndrueshmëria financiare	Totali(20 pikë)
Parashikime financiare realiste dhe të realizueshme	10 pikë
Potenciali për përfitim dhe qëndrueshmëri afatgjate	10 pikë
Ndikimi social dhe mjedisor	Totali(25 pikë)
Aplikuesi është i moshës 18 deri në 35 vjeç	5 pikë
Projekti ka ndikim pozitiv në ambient	5 pikë
Aplikuesi është grua	5 pikë
Aplikuesi është pjesëtar i komunitetit pakicë	5 pikë
Aplikuesi është me nevoja te veqanta	5 pikë
	TOTALI : 100 Pikë

¹Kalueshmëria e projektit është mbi 50 pikë.

3.3 Kontrolla në terren

Gjatë fazës së kontrollit në terren, komisioni i Komunës së Gjilanit do të vizitojë vendet ku biznesi i zhvillon aktivitetet dhe do të verifikojë nëse gjendja e aplikuesit në terren është në përputhje me projekt-propozimin e dorëzuar nga aplikuesi.

Nëse nuk ka përputhshmëri në mes të projekt-propozimit dhe gjendjes në terren, projekt propozimi do të skualifikohet.

4. PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR PËR APLIKIM

4.1 Periudha e aplikimit

Periudha e aplikimit do të jetë e hapur nga **28.03.2025 deri me 28.04.2025**. Aplikimi bëhet duke plotësuar shtojcat e parapara në pikën 2.2. për LOT 1-Start up dhe 2.4 për LOT 2- Bizneset ekzistuese të grave dhe duke bashkangjitur dokumentet e kërkuara në këto pika të këtij udhëzuesi.

Aplikacionet duhet të plotësohen në formë kompjuterike duke mos ndryshuar formatin e aplikacioneve të dizajnuara nga Komuna e Gjilanit për këtë thirrje. Dokumentet për aplikim, mund të shkarkohen nga web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit. Dokumentet e bashkangjitura duhet të jenë me dukshmëri të qartë.

Aplikacionet e shkruara me dorë dhe në ndonjë format tjetër nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e plotësuar me të gjitha informatat relevante në lidhje me veprimtarinë, do të kalojnë për vlerësim.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të skualifikohet.

Komuna e Gjilanit nuk është përgjegjëse për koston që ndërlihet me përgatitjen e aplikacionit dhe se këto shpenzime nuk janë të pranueshme nëse përfshihen në projekt.

Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe dhe serbe.

4.2 Mënyra e aplikimit dhe afati i fundit për aplikim

Aplikacionet e kompletuara në një kopje fizike duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në:

Qendra për Shërbime me Qytetar (QSHQ)

Komuna e Gjilanit duke shënuar “FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE TË GRAVE 2025”, si dhe emrin e plotë të aplikuesit dhe LOT-in për të cilin aplikohet.

Afati i fundit për aplikim është 28.04.2025, në ora 16:00.

Aplikacionet e pranura pas përfundimit të këtij afati nuk do të merren parasysh në çfarëdo rrethane.

4.3 Numri i aplikimeve

Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike.

Në rast se konstatohet se ndonjë aplikant ka dorëzuar më tepër se një aplikacion në këtë Thirrje publike, i/e njeiti do të diskualifikohet. Të gjithë përfituesit (pronaret e bizneseve) që kanë përfituar grante nga Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2023-2024 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje.

4.4 Informata të mëtutjeshme për aplikim

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të organizoj sesion informues me 03.04.2025 në Sallën e KK Gjilan si dhe do të caktojë zyrtarë përgjegjës për dhënien e informatave rreth kësaj thirrje.

Aplikantët potencial mund të parastrojnë pyetje shtesë lidhur me këtë thirrje duke i dërguar ato në email-in: filloreta.idrizi@rks-gov.net jo më vonë se deri më **21.04.2025** në ora **16:00**.

Me rastin e parashtrimit të pyetjeve ato duhet të jenë të qarta, të detajuara si dhe duhet specifikuar qartë pyetjen si dhe LOT-in të cilit i referohet pyetja.

DZHE nuk ka për obligim të ofrojë përgjigje në pyetjet e dërguara pas datës **21.04.2025**

4.5 Kohëzgjatja apo plani i veprimit:

Kohëzgjatja e planifikuar e realizimit të projektit nuk mund të tejkalojë tre (3) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

4.6. Nënshkrimi i Kontratës dhe Ankesat

Komuna e Gjilanit do të formoj komision të pavarur dhe profesional për vlerësimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve do të bëhet publikimi i listës preliminare. Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikantët e pakënaqur mund të adresojnë ankesën e tyre përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë në Komunen e Gjilanit brenda 5 dite nga data e publikimit të rezultateve preliminare.

Pas shqyrtimit të ankesave do të bëhet publikimi i listës finale të përfituesve dhe do të bëhet nënshkrimi i kontratave me përfitues.

Pas përzgjedhjes së përfituesve dhe **para nënshkrimit të kontratës**, përfituesit janë të obliguar që të sigurojnë këto dokumente:

- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare në emër të biznesit (për LOT 1 dhe LOT 2).
- Dëshmia bankare për deponimin e mjeteve të bashkëfinancimit të biznesit (për LOT 1 dhe LOT 2).

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit me informatat përcjellëse (për LOT 1-bizneset start up).
- Raporti Kreditor i lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (për pronarin /pronarët dhe për biznesin) për LOT 1 dhe LOT 2.

Pas nënshkrimit të kontratës dhe para transferit të mjeteve në xhirollogari të përfituesit, përfituesi duhet të dorëzojnë garancion bankar ose nga Kompanitë e sigurimit me kohëzgjatje prej 6 muajve për shumën e grantit të aprovuar nga Komuna e Gjilanit.

4.7 Orari Indikativ

Aktiviteti	Data	Ora	Vendi
1.Hapja për aplikim	28.03.2025		Webfaqe te Komunës së Gjilanit
2. Sesioni informues	08.04.2025	11:00-13:00	Salla e Kuvendit Komunal, Gjilan
3.Afati i fundit për parashtrimin e pyetjeve	21.04.2025	16:00	filloreta.idrizi@rks-gov.net
4. Data e fundit që Autoriteti Kontraktues jep sqarime në pyetjet e parashtruara	25.04.2025	16:00	Webfaqe të Komunës së Gjilanit
5.Afati i fundit për aplikim	28.04.2025	16:00	Qendra për Shërbim me Qytetar (QSHQ)
6.Publikimi i rezultateve preliminare	28.05.2025		Webfaqe te Komunës së Gjilanit
7. Mbyllja e afatit të ankesave	02.06.2025	16:00	QSHQ
8. Kthimi i përgjigjeve palëve lidhur me ankesa	13.06.2025	08:00-16:00	QSHQ
9 .Nënshkrimi i kontratave	23.06.2025		DZHE, Komuna e Gjilanit